



MONITORIMI I MEDIAVE '05

Zgjedhjet Parlamentare 2005

**Periudha e Monitorimit
14 - 27 Maj 2005**

Tirane, 2 Qershor 2005

PERMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	3
Hyrje	4
Metodologjia dhe Terminologjia	5
Informacion i Përgjithshëm	6
Monitorimi i medias u krye nga katër organizata	6
Struktura e Monitorimit	7
Lista e mediave të monitoruara	7
TELEVIZIONI	8
RADIO	18
GAZETAVE	22

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Faktori që e përshkruan më së miri median shqiptare, është ndasia brenda medias në lidhje me besnikërinë ndaj njëres prej dy forcave më të mëdha politike – PS-së dhe PD-së.
- Televizioni dhe radioja publike raportuan në një mënyrë fuqimisht mbështetëse karshi PS dhe Qeverisë. Ato nuk e përmbushën rolin e tyre që të raportojnë në një mënyrë të balancuar, pavarësisht faktit se ato financohen drejtpërdrejtë nga taksapaguesit. Ne rekomandojmë që në të ardhmen ata të rishikojnë qendrimin e tyre dhe të raportojnë në një mënyrë më të ekuilibruar.
- Një grup i medias private mbështeste PS-në në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes ofrimit të mbështetjes për Qeverinë, dhe kjo mbështetje ishte lehtësisht e dallueshme. Grupi tjetër mbështeste PD-në nëpërmjet një mënyre më pak të dallueshme dhe në një shkallë më të ulët.
- Aktivitete të ndryshme të Qeverisë morën një masë të konsiderueshme kohë në të gjitha transmetimet e mediave të monitoruara.
- Sidoqoftë, shumica e gazetave nuk raportuan për Qeverinë dhe në vend të saj i kushtonin një hapësirë të konsiderueshme veprimtarive zgjedhore të partive politike. Një numër më i madh gazetash mbështesnin PD-në dhe vetëm një gazetë ishte paksa dashamirëse kundrejt PS-së
- Top Channel dhe Egnatia TV raportoi në një mënyrë kryesisht të ekuilibruar.
- Është e qartë se partitë politike më të vogla nuk përfituan hapësirë ose kohë të konsiderueshme për të shprehur opinionet e tyre. Kjo situatë ishte më e dukshme për LSI-në në TVSH, TVA dhe TV KOHA.
- Media private duhet të tregojë vëmendje të veçantë gjatë periudhës zgjedhore përderisa edhe ajo e ka për detyrë t'i shërbejë publikut, bazuar mbi standarde gazetarie të shëndosha dhe të pranuar.
- Grate lidere të politikës pothuajse nuk kanë mbështetje nga media, në krahasim me lideret meshkuj.

Ky projekt u mundësua falë mbështetjes së dhënë nga Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, i cili financohet nga USAID nën marrëveshjen e bashkëpunimit nr. 182-A-00-04-00104-00 me National Democratic Institute for International Affairs. Opinione të shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it.

HYRJE

Ndërsa është e pamundur të vendoset demokracia në një vend pa pasur zgjedhje të vërteta, procesi demokratik shtrihet edhe më përtej Ditës së Zgjedhjeve. Qeverisja demokratike kërkon një qytetari aktive dhe të informuar. Shpesh, medias i referohemi si Pushteti i Katërt, gjë që tregon rolin e saj të rëndësishëm në një shoqëri. Në demokraci ne presim që media të veprojë si një mbikëqyrës i ngjarjeve dhe vendimeve, për të ndihmuar qytetarët që të jenë të informuar për atë çka ndodh. Por ky rol mund të përmbushet vetëm atëherë kur pasqyrimi mediatik të ndjekë parime dhe praktika thelbësore.

Monitorimi i medias është një mjet që ndihmon gazetarët të raportojnë në një mënyrë më të saktë dhe më të barazpeshuar. Me pak fjalë ai duhet të konsiderohet si një mjet i cili do të rrisë besimin e qytetarëve në raportimet e përgjithshme të medias. Kudo që ekziston media, është e dobishme të ndiqet puna e saj dhe më pas të analizohet marrëdhënia e saj me subjektet e ndryshme. Monitorimi i medias është një disiplinë studimi që përmban elementë analitikë. Qëllimi i tij është që të ndihmojë median në krijimin e barazpeshës gjatë raportimit dhe për të pasqyruar gabimet profesionale. Gjatë periudhës së vëzhgimit detyra e skuadrës monitoruese është përftimi i të dhënave që pasqyrojnë ndjenjat e vërteta të qytetarëve që shikojnë, dëgjojnë dhe lexojnë median e shënjestruar.

Monitorimi i medias është i zakonshëm në mbarë demokracitë, të vogla dhe të mëdha. Shoqata e Gazetarëve të Rinj (AYJ) në Mal të Zi po bën një monitorim të pandërprerë të brendshëm të medias; gjetjet që pasuan këto përpjekje kanë ndikuar ndjeshëm në qëndrimet e medias, që prej fillimit të këtij programi në vitin 2000. Monitorimi cilësor duhet të bazohet në një metodologji shkencore të shëndoshë sikurse ajo që është duke përdorur aktualisht Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit.

Sot ne përdorim më shumë metodologji dhe njëra është ndërmarrë nga Instituti European i Medias EIM. Gjatë zgjedhjeve parlamentare në 2001, AYJ me mbështetjen e EIM-së kreu një monitorim të zgjeruar, duke vëzhguar 6 orë programe në median elektronike. Si të tilla, metodologjitë e përdorura kontrollohen nga shumë organizata ndërkombëtare. Qëllimi i raporteve është të ndihmojnë median, po të jetë e nevojshme, për të korrigjuar raportimin e tyre për tematika të ndryshme që vrojton ekipi monitorues.

Parimet e gazetarisë së mirë

Ekzistojnë parime thelbësore që pranojnë gjerësisht si përbërës të “gazetarisë së mirë”. Mes tyre janë:

- Respekto etikën e gazetarisë së mirë.
- Raporto në mënyrë të drejtpeshuar në lidhje me kohën/hapësirën dhe kontekstin e informacionit.
- Bëni dallimet ndërmjet zyrtarëve të qeverisë dhe partisë sunduese.

- Mos e përdorni Qeverinë si mjet promovues për kandidatët dhe alternativat e politikave.
- Shmangni caktimin e një kohe të tepruar për aktivitetet e qeverisë në kurriz të aktorëve të tjerë politikë.
- Gjithmonë ofroni anën tjetër/të sulmuar për t'iu përgjigjur kritikës.
- Media duhet të orientojë politikanët për atë që është e rëndësishme për qytetarët.
- Mos nxisni fjalime urrejtjeje.
- Media është rojtari publik dhe duhet të sillet si i tillë.

Thuhet se njëanshmëria dhe raportimi joprofesional nuk do të ndikojnë tek votuesit e vendosur. Për shkak se raportimi i dobët shtrembëron perceptimin, kjo gjë mund të ndikojë votuesit e pavendosur dhe ky shtrembërim i së vërtetës është gjithçka i'u mbetet qytetarëve për të mbështetur vendimet e tyre. Në vend që t'i detyrojë shtetasit të marrin vendime, roli i medias është të informojë qytetarët për të gjitha ngjarjet e rëndësishme, me qëllim që ata të bëjnë një zgjedhje të mirë-informuar. Ky raportim duhet të jetë i baraspeshuar, i përpiktë, i saktë dhe i drejtë. Ai duhet t'u ofrojë të njëjtën mundësi të gjitha palëve për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre. Qeveritë kanë rolin e rëndësishëm që të mos e pengojnë median në luajtjen e këtyre funksioneve dhe të ndihmojnë pluralizmin e medias me qëllim që t'i shpalojnë para publikut larminë më të gjerë të burimeve të informacionit.

METODOLOGJIA DHE TERMINOLOGJIA

Në monitorimin e medias përdoren dy metoda kryesore - cilësore dhe sasiore. Të dy parimet janë mjaft të rëndësishme për paraqitjen e një panorame të përgjithshme të raportimit të medias në një fushatë elektorale.

Analiza cilësore

Në kërkimin cilësor elementët kryesorë janë konteksti dhe paraqitja.

Konteksti është vendosja në kohë dhe hapësirë e vetë informacionit. Për shembull, nëse partia politike A flet në kontekst pozitiv për veten e saj ose në kontekst negativ për ndonjë subjekt tjetër, një media nuk është e njëanshme thjesht sepse e transmeton informacionin. Ajo që ka rëndësi është nëse media, për një periudhë më të gjatë, jo vetëm për atë ditë, transmetoi informacion me kontekst pozitiv ose negativ mbi subjektet e ballafaquara në mënyrë përzgjedhëse në mënyrë që të zhvillohet një shabllon i spikatur.

Paraqitja është shkalla në të cilën ngjarjet raportohen me fakte (X gjë ndodhi) kundrejt sasisë së komentit redaksional ose të ndikimit mbi këto ngjarje.¹ Për shembull, fjalët

¹ Ju nuk do të gjeni në cdo grafik të cituar analizë për këtë lloj raportimi. Nëse nuk ka probleme madhore në këtë fushë, ne nuk do t'i paraqesim ato.

mund të jenë pozitive ose negative. Gjithashtu, toni i përdorur prej gazetarit gjatë pasqyrimit të lajmit mund të ndikojë perceptimin. Së fundmi, mimika e fytyrës dhe gjuha e shenjave (për gazetarët televizivë) ndikon mënyrën se si perceptohet informacioni.

Analiza sasiore

Analiza sasiore vlerëson kohën dhe hapësirën në të cilën një parti politike ose politikan u përmend, foli, u citua ose u shfaq në ekranin e televizorit.

-Kohë/Hapësirë e përgjithshme do të thotë harku kohor që televizionet dhe radiot i kushtojnë raportimit mbi një subjekt të caktuar politik, ose, masa e hapësirës që gazetat u kushtojnë aktiviteteve të partive politike ose Qeverisë.

-Citimi është koha ose hapësira e dhënë për një gazetar për të ritreguar fjalët e dikujt tjetër.

-Deklaratë e shkurtër (ose thënia e shkruar për median e shkruar): është koha ose hapësira që media i jep partive politike për të shprehur opinionet e tyre politike dhe përfaqëson një pjesë të kohës së tyre të përgjithshme. Kjo kategori përfshin intervistat dhe njoftimet e bëra drejtpërdrejt nga partitë politike ose subjektet politike.

-Koha e objektit është koha kur subjekti X është duke folur për politikanin Y - politikanin Y është objekt i fjalimit. Kjo përfshin rastet në të cilat gazetarët përmendin subjektet politike në artikujt e tyre ose kur të tjerët flasin për subjektet politike

-Burimi: ku media merr informacionin, si psh agjencitë e lajmeve ose mediat e tjera, si dhe deklaratat e ndryshme shtypi, raporte dhe njoftime të tjera.

INFORMACION I PERGJITHSHEM

Monitorimi i medias u krye nga katër organizata.

Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit (ACAC)

ACAC u krijua në 2001 për të ulur korrupsionin duke forcuar rolin e shoqërisë civile dhe duke u koordinuar me Qeverinë. Qëllimet e tyre janë që të rrisin vetëdijen për shkaqet dhe kostot e korrupsionit si dhe që të shndërrojnë këtë vetëdije në përkrahje të reformave për të ulur dhe për të luftuar korrupsionin.

Instituti për Sondazhe dhe Opinione (ISO)

I themeluar në vitin 200 ky institut është një qendër e pavarur për kërkime sondazhi i cili ofron shërbime për organizata të sektorit publik dhe privat. Në mënyrë të rregullt ISO shikueshmërinë e medias elektronike dhe lexueshmërinë e medias së shtypur. Përveç personelit të përhershëm, ISO punëson dhe 25 ekspertë të tjerë të jashtëm dhe ka një panel prej 4000 njerëzish në 36 rrethe të Shqipërisë.

Instituti për Kërkime Zhvillimi dhe Alternativa (IDRA)

Kërkimet IDRA është njësi e kërkimeve për sondazh social dhe marketing e Institutit për Kërkime Zhvillimi dhe Alternativa (IDRA). Ai ofron studime për klientë institucionale

dhe privatë. Ai ka një rrjet prej më shumë se 150 intervistuesish të cilët mbulojnë të gjitha rajonet e Shqipërisë dhe Kosovës.

Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë (CTFI)

Qëllimi i kësaj qendre është rritja e ndërgjegjësimit publik për një demokratizim të vazhdueshëm të jetës shqiptare si dhe për zbatimin e politikave kombëtare në luftën kundër korrupsionit. Disa nga projektet e realizuara prej kësaj qendre janë: Maj-Dhjetor 2003: “Media për transparencë”.

Struktura e Monitorimit

- Monitorimi i televizioneve – u krye nga ISO
- Monitorimi i radiove – u krye nga IDRA
- Monitorimi i gazetave – u krye nga CTFI

Projekti i përgjithshëm po kryhet nën ombrellën e ACAC. Projekti kryesohet nga Komisioni Drejtues i përbërë prej katër organizatash. Ky komision përcaktoi listën e përpiktë të mediave që do të monitorohen në këtë projekt. Mediat u zgjodhën sipas gjetjeve të një studimi të shkurtër mbi ndikimin e medias në Shqipëri.

Në këtë projekt janë përfshirë 23 monitorues, përveç tre koordinatorëve, një koordinator kryesor dhe personal tjetër – teknikë, financiarë, menaxherë të rrjetit. Personalitë u zgjodhën me kujdes për të mos qenë i njëanshëm dhe politikisht aktiv. Monitoruesit ndryshojnë rregullisht brenda tre grupeve të mediave që të mund të marrin sa më shumë informacion të ndryshëm që të jetë e mundur.

Lista e mediave të monitoruara

Televizionet: TVSH, TOP CHANNEL, KLAN, KOHA, TVA, VIZION +, NEËS 24, ALSAT, TEUTA, EGNATIA.

Radiot: Radio Tirana, Top Albania Radio, Radio Rash, Radio +2.

Gazetat: Të gjitha gazetat politike u monitoruan pa kufizim.


Raporti vijues është i bazuar në monitorimin e medias vetëm pak përpara periudhës zyrtare zgjedhore që filloi në 30 maj. Kështu që, është një vlerësim që ofron një shikim mbi sjelljen e medias në zonën gri ndërmjet ligjeve që kontrollojnë pasqyrimin mediatik gjatë zgjedhjeve dhe ndjeshmërive të lexuesve, dëgjuesve dhe shikuesve në momentet kulmore përpara se të nisë fushata zyrtare.

TELEVISIONI

ALSAT


Megjithëse ky stacion raporton kryesisht për Qeverinë, transmetimi i tij i jepte një shtytje të fortë PD-së për shkak se Alsati e pasqyrore këtë parti me më shumë sekuenca pozitive dhe PS-në në një kontekst më negativ. LSI-ja dhe PDR-ja gjithashtu morën një sasi të dukshme kohore në një dritë kryesisht pozitive. Përsa u përket deklaratave të shkurtra, Nano mori pjesën më të madhe të kohës për të folur drejtpërdrejtë. Berisha, Meta, Pollo u paraqitën kryesisht në dritë pozitive.

Total time




ALSAT

Context




Politician soundbite



ALSAT


Politician context




KLAN

Ky stacion tregoi mbështetje pthujse të barazpeshuar në kohë për PS/Qeveri (40%) dhe për PD-në (33%). Në kontekst ky stacion është më pozitiv për PD-në (106 pozitive dhe 41 negative) sesa për PS-në (99 pozitive dhe 74 negative). E njëjta situatë qëndron edhe për udhëheqësit politikë: Sali Berisha ka më shumë kohë dhe në kontekst pozitiv sesa Fatos Nano, i cili mori dy herë më shumë pasqyrim negativ krahasuar me Berishën. PD mori 7% më shumë kohë se PS me një përqindje të përafërt konteksti pozitiv dhe asnjans, por me një shifër shumë më të lartë informacioni negativ për PS-në.


Total time




Context



Politician soundbite




Politician context



NEWS 24


Ky stacion transmetoi një kohë të barazpeshuar ndërmjet dy partive politike kryesore. Konteksti i këtij informacioni ishte gjithashtu i barabartë. Megjithatë, edhe koha që i jepej Qeverisë ishte 21% dhe ky informacion ishte përgjithësisht pozitiv. News 24 pasqyroj PS/Qeverinë në 45% të kohës ku PD mori 25% të pasqyrimet. Megjithatë partitë kryesore morën trajtim pothuajse të barabartë të deklarimeve të shkurtra, Qeveria siguroi relativisht më tepër kohë për citime të drejtpërdrejta. Nano dhe Berisha janë më të përfaqësuarit mes udhëheqësve politikë përse i përket kohës së mbulimit. Nano ka një epërsi të lehtë përse i përket kohës së caktuar dhe kjo kohë ishte kryesisht më pozitive përse i përket kontekstit. Asnjëra prej partive më të vogla nuk mori kohë të ndjeshme.

Total time




NEWS 24

Context




Politician soundbite





NEWS 24

Politician context



TOP CHANNEL


Ky stacion priret të pasqyrojë në mënyrë të barabartë të dyja partitë e mëdha (26%). Stacioni transmeton pozitivisht aktivitetet e Qeverisë (20%). Përsa i përket kontekstit, PS-ja ka një avantazh të lehtë me 91 shprehje pozitive dhe 29 përmendje negative. Për PD-në, krahasimi është 72 pozitive dhe 43 negative. LSI-ja mori 6% me 34 pozitive dhe 11 negative.




TVSH

Megjithëse stacion i shërbimit publik, ky stacion ka detyrimin më të madh për të raportuar në mënyrë të barazpeshuar. Nga analiza jonë, ne besojmë se ky stacion nuk e ka përmbushur këtë rol. Gjetjet tona sugjerojnë se ai është tepër mbështetës ndaj PS-së, duke i dhënë asaj një pjesë të ndjeshme kohe pozitive të transmetimit të tij (33%) si dhe duke i dhënë kohë të madhe Qeverisë (31%). PD-ja mori 15% kohë - me më shumë se gjysmën e kësaj si kontekst negativ. Kjo analizë tregon se ky stacion televiziv, i vetmi i shërbimit publik në vend, ia cakton 64% të programeve politike të tij partisë politike në pushtet në mënyrë kryesisht pozitive. Skenare të ngjashme transmetohen dhe në paraqitjen e politikanëve dhe deklaratat e tyre të shkurtra, ku Nano ka përparësi të trefishtë ndaj Berishës. Për më tepër, TVSH-ja jep 4 herë më shumë deklarata të shkurtra të Nanos sesa Berishës.


Total time




Context



Politician soundbite





Politician context




EGNATIA

Egnatia TV është një nga stacionet televizive të rralla që nuk raporton ndjeshëm veprimtaritë e Qeverisë, duke i kushtuar asaj vetëm 6% të kohës. Shumica e raportimit ishte për PS-në dhe PD-në dhe kjo gjë kryhej në një mënyrë pothuajse të barazbeshuar. Gjithashtu, ky stacion i kushton Nanos një numër informacionesh negative në masë të konsiderueshme. Nano mori 18 pikë negative dhe vetëm 3 pikë pozitive, ndërsa Berisha mori 15 negative dhe 13 pozitive.



KOHA


Ky stacion anonte nga PS-ja dhe Qeveria, pasi pjesën më të madhe të kohës ia kushtonte të djave në mënyrë mjaft pozitive. Ndërsa numri i rasteve të përmendjes së PD-së në kontekst negativ ishte i barabartë me atë të PS-së/Qeverisë, dhe numri i informacioneve pozitive ishte sa gjysma e partisë në pushtet. Nano mori dy herë më shumë kohë për deklarata të shkurtra dhe u përmend katër herë më shumë pozitivisht sesa negativisht. Ajo që binte në sy ishte mbulimi i pakët që u jepej partive politike më të vogla.



TEUTA


Nuk kishte njëtrajshmëri në raportim, pasi kishte ditë kur ky stacion mbulonte vetëm veprimtaritë e PD-së, ndërsa ditët e tjera përqëndrohej në veprimtaritë e PS-së. Në përgjithësi, ky stacion duket mbështetës për PD-në. Për shembull, Berisha mori më shumë pasqyrim pozitiv (26 sekuenca pozitive ndaj 4 negative), krahasuar me pasqyrimin e Nanos (15 sekuenca pozitive përkundrejt 9 negativeve). Lidhur me partitë në përgjithësi, PD-ja mori 8% më pak kohë sesa PS-ja dhe Qeveria bashkë.

Total time




TEUTA

Context




Politician soundbite



TEUTA


Politician context




TVA

Gjetjet tona tregojnë se ky stacion është fuqimisht pro PS-së/Qeverisë nëpërmjet raportimeve shpesh jo të barazpeshuara. PD merrte 21% të kohës së programit politik në emisionet e lajmeve kryesore, ndërsa PS/Qeveria merrte 61% dhe në lidhje me kontekstin këto subjekte paraqiteshin tre herë si të favorshme për PS-në se sa për PD-në. Për neve kjo tregon mbështetje të qartë për PS-në. Lidhur me vetë politikanët, situata është po kështu e ngjashme. Në lajmet kryesore, Nano merrte mbi tre herë më shumë kohë transmetimi për të shprehur pikëpamjet e tij në krahasim me Berishën. Po kështu, ky stacion tregonte sasi shpërpjestimore informacioni mbi Nanon i cili merrte 38 informacione pozitive dhe vetëm një negativ. Në këtë kontekst është e vështirë të flitet për një raportim të barazpeshuar në TVA.


Total time




Context



Politician soundbite




Politician context



VIZION +


Vizion + i kushtoi pjesën më të madhe të kohës diskutimit për qeverinë, ky raportim ishte i barazpeshuar me poshujt e njëjtin numër informacionesh pozitive dhe negative. Në këtë stacion televiziv ka një raportim të barazpeshuar për PS/Qeverinë, në lidhje me kontekstin por ekziston një dallim i madh në kohën totale kushtuar PS/Qeverisë (53%) në krahasim me PD (25%), ndërkohë që raportimi për PD-në ishte më pozitiv. Për më tepër anëtarë drejtues të PD-së morën më shumë kohë për deklarata të shkurtra. Raportimi për PS-në ishte i barazpeshuar kontekstualisht, ndërkohë që raportimi për PD-në ishte më pozitiv. Vlerësimi në kontekst për Berishën ishte më pozitiv sesa negativ dhe për Nanon ishte kryesisht i barazpeshuar.




RADIO

RADIO TIRANA²


Radio Tirana dallohet sepse i ka kushtuar një pjesë të madhe kohe informacioneve që mbulojnë PS-në/Qeverinë. Mbulimi i PS-së dhe PD-së është i barazpeshuar (18% dhe 19% respektivisht), ky mund të jetë ndoshta mendim keqorientues për shkak të kohës që rezervohet për Qeverinë PS dhe Qeveria bashkë morën 66% të kohës (PS-ja 18%; Qeveria 48%) në krahasim me 27% për PD-në dhe aleatët e saj. Ndërsa informacioni pozitiv për PS-në dhe PD-në është pothuaj i njëjtë në raport me informacionin e përgjithshëm të dhënë për këto parti (64% dhe 65% përkatësisht), 78% e informacionit të dhënë për Qeverinë jepet në dritë pozitive. Radio Tirana i jep Nanos 2.5 herë më shumë kohë për deklarata të shkurtra sesa Berishës. Në fakt, shumica e deklaratave të shkurtra i jepen Nanos si Kryeministër, por kjo nuk ka ndonjë rëndësi nga pikëpamja e dëgjuesit.



SoundBits - Politicians





Context – politicians



² Other Parties - Refers to the time of all other parties which has been less than 2% of total time.

TOP ALBANIA RADIO


Ky stacion i kushtoi 36% të kohës së tij Qeverisë, 23% PD-së dhe 18% PS-së. Komentari për Qeverinë është i barazpeshuar (44% e sekuencave është në dritë pozitive dhe 35% në dritë negative). Informacioni i dhënë për PD-në jepet në dritë më pozitive (58% e informacionit është në dritë pozitive dhe 19% negative). Në përgjithësi të dyja partitë politike kryesore “bëjnë paraqitje” pozitive në kontekstin e përgjithshëm. Nano mori 25% më shumë deklarata të shkurtra sesa Berisha. Duket sikur ka një barazpeshë në sekuencat pozitive që ka marrë Nano dhe Berisha në kontekst por ka më shumë sekuenca negative për Nanon sesa për Berishën.




RADIO RASH

Radio Rash ka ruajtur baraspeshimin në sasinë e kohës së caktuar për partitë politike kryesore (22% për secilën) dhe 8% LSI-së. Prania e Qeverisë në këtë stacion radioje zë 28% të pasqyrimit të përgjithshëm. Nëse pikët e tyre bashkohen, ky stacion i ka dhënë rreth gjysmën e kohës Qeverisë dhe PS-së, ndërsa PD ka 23% të kohës. Lidhur me kontekstin, pamja është e njëjtë për partitë politike kryesore duke qenë kryesisht pozitive. Megjithatë, shumica e “pozitivitetit” të Qeverisë dhe PS-së u jep atyre një përparësi të përgjithshme më të mirë. Në mënyrë mjaft interesante, Radio Rash nuk ka patur Deklarata të Shkurtra gjatë kësaj periudhe monitorimi. Kështu, mikrofoni nuk ka qenë në “terren” në kërkim të politikanëve për të folur drejtpërdrejt në këtë stacion.


Total time




Context



Politician soundbite





Politician context



RADIO +2



Qeveria ka marrë rreth 40% të kohës së përgjithshme të transmetimit, PD rreth 23%, PS 15% dhe LSI 5%. Qeveria dhe PS bashkarisht (përfshirë aleatin e tyre PSD) kanë zënë rreth 55% të kohës së përgjithshme, ndërsa PD (me të gjithë aleatët e saj PDR dhe PR) rreth 23% të kohës së përgjithshme. Lidhur me kontekstin, ka një pamje mjaft të baraspeshuar ku të dyja partitë kanë “bërë paraqitje” më pozitive ndërsa qeveria mori dyfishin e sekuencave pozitive krahasuar me ato negative. Radio +2 nuk ka patur Deklarata të Shkurtra gjatë kësaj periudhë. Ka një baraspeshim të gjerë ndërmjet dy politikanëve kryesorë - Nano dhe Berisha – dhe ky barazpeshim vërtetohet me të dy grafikët (të cituar dhe nga Konteksti i Politikanëve të përmendur).




GAZETAVE

BALLKAN

Kjo gazetë i ka dhënë më shumë dritë pozitive PS-së, dhe i ka kushtuar 88% PD-së dhe PS-së bashkë. Hapësira e përgjithshme që u është kushtuar atyre është pothuajse plotësisht e baraspeshuar – PS (43 %) dhe PD (40%). Politikanët më të përfaqësuar janë Nano dhe Berisha, të cilët ndajnë një mbulim shumë të përafërt në lidhje me hapësirën. Meta siguroi 18 % të pasqyrimit. Udhëheqës të tjerë të partive si Gjinushi dhe Dule marrin mbulim më të madh se në gazetatat e tjera. Në lidhje me mbulimin e kontekstit, vlerësimet qartazi favorizojnë PS-në në një raport gati 2:1 me PD-në por Meta kishte një kontekst shumë favorizues me 7 sekuenca pozitive dhe dy negative. Pasqyrimi kontekstual për PD-në është pothuajse i barazbeshuar. Nano vendoset kryesisht në kontekst pozitiv kurse Berisha në kontekst negativ. Gjinushi, Meta, Dule vendosen në kontekst kryesisht ose teresisht pozitiv.




A




KORRIERI

Kjo gazetë është paksa mbështetëse e PD-së dhe LSI-së. Ndërsa si PS ashtu dhe PD zënë pothuajse të njëjtën hapësirë me rreth (28% dhe 27% respektivisht) dhe Qeveria zë vetëm 3 %. Barazpesha shtremberohet kur fjala vjen tek konteksti ku PD-ja ka kontekst më negativ (19) sesa pozitiv (14) dhe PS-ja të kundërtën (26 pozitive; 20 negative). LSI është partia e tretë me 16%, e ndjekur nga LZHK dhe të dy këto parti vendosen kryesisht në kontekst pozitiv. Panorama ndryshon kur u monitoruan udhëheqësit politikë. Meta është shumë afër Nanos dhe Berishës përsa i përket hapësirës së mbulimit. Mbulimi i kontekstit është pothuajse i përmbytur kur krahasohet me atë të partive politike. Nano vendoset në kontekst më negativ krahasuar me Berishën, kurse konteksti pozitiv për të dy është gati i njëjtë. Ilir Meta siguron 24 % të mbulimit të politikanëve në një kontekst të lartë pozitiv (5 sekuenca pozitive dhe vetëm një negative).


Total time




Context



Politician soundbite




Politician context




SHEKULLI

Kjo gazetë mban qëndrim të dallueshëm mbështetës ndaj PD-së. Në lidhje me hapësirën, gjetëm se ka një prirje të qartë drejt PD-së pasi lajmet për PD-në zënë 47% të mbulimit në krahasim me 21% për PS-në, ndërsa mbulimi i qeverisë zë vetëm 12%. LSI vjen e treta me 10% të kohës totale të pasqyrimit e ndjekur nga Partia e Bleritë me 4%. Nanos dhe Berishës i kushtohet gjerësisht e njëjta hapësirë mbulimi dhe ata ndiqen nga Ilir Meta dhe Gramoz Ruçi përkatësisht. Në lidhje me pasqyrimin kontekstual PD mbulohet më pozitivisht në krahasim me PS dhe Qeverinë së bashku. Berisha pasqyrohet më pozitivisht sesa Nano. Politikanë si Ilir Meta, Genc Pollo, Fatmir Mediu, Leka Zogu, Skënder Gjinushi mbulohen kryesisht në kontekst pozitiv me përjashtim të Gramoz Ruçit i cili nuk ka arritur të marrë as edhe një pikë të vetme pozitive.


Total time




Context



Politician soundbite




Politician context




KOHA JONË

“Koha Jonë” është dukshëm mbështetëse e veprimeve të PD-së, dhe mban qëndrime kundër qeverisë. Megjithëse kur bashkohet hapësira kushtuar PS-së dhe Qeverisë, vëmë re se shifra arrin deri në 45%, por konteksti dhe paraqitja është dukshëm negative. LSI vjen e treta me 11% dhe vendoset kryesisht në kontekst pozitiv. PDK vjen e katërta dhe vendoset plotësisht me kontekst pozitiv. Përsa u përket përqindjeve për udhëheqësit politikë, vihet re e njëjta përqindje. Nano vjen i pari me 41% të hapësirës së përgjithshme, dhe vendoset kryesisht në kontekst negativ, ndërsa Berisha vjen i dyti me 27%, i vendosur pothuajse plotësisht në kontekst pozitiv. Ndryshe nga përqindja e PDK-së, udhëheqësi i kësaj partie, Nikollë Lesi, që është edhe botues i gazetës Koha Jonë, zë një përqindje jashtëzakonisht të lartë dhe vendoset në kontekst pozitiv.


Total time




Context



Politician soundbite




Politician context




PANORAMA

Kjo gazetë ka një hapësirë dhe kontekst të baraspeshuar për dy partitë politike kryesore (PS 32%; PD 34. LSI-ja zë një hapësirë më të madhe sesa në gazetatat e tjera të monitoruara (20%) dhe konteksti është pozitiv. Megjithatë, kur bëhet fjalë për vlerësimin cilësor njëanshmëria është më e dukshme. PD vlerësohet mjaft pozitivisht në krahasim me PS-në. Citimet nga Nano zënë 29% hapësirë në krahasim me Berishën citimet e të cilit zënë 24%. Edhe Ilir Meta është i mbuluar mirë me 14%. Nano mbulohet më pozitivisht nga ana kontekstuale se Berisha. Ilir Meta është i vendosur në një kontekst kryesisht pozitiv dhe asnjans. Shumica e udhëheqësve të tjerë politikë zënë vetëm pak hapësirë me përjashtim të Genc Pollos të PDR-së, i cili zë 4% të hapësirës në kontekst pozitiv dhe asnjans.


Total time




Context



Politician soundbite



Politician context




GAZETA SHQIPTARE


Kjo gazetë ka raportim thuajse të barabartë për të gjitha subjektet, dhe si shumë të tjera u kushton një pjesë të vogël të hapësirës Qeverisë. Ajo i jep PS-së/Qeverisë gati të njëjtin nivel mbulimi (PS 32%, Qeveria 6%) që i jep PD-së (30%). PS dhe PD marrin pothuajse të njëjtin vlerësim megjithëse Qeveria vlerësohet kryesisht në kontekst pozitiv. Mbulim u jepet edhe partive të tjera, për shembull, LSI-së e cila vjen e treta, LZHK-së që vjen e katërta. LSI mbulohet kryesisht në dritë negative. Nano vjen i pari për sa i përket citimeve të shkruara sesa Berisha që e ndjek nga afër. Vlerësimi pozitiv është mbisundues për Nanon ndërsa vlerësimet pozitive dhe negative për Berishën janë pothuajse të njëjta. Politikanëve të tjerë u jepet mbulim i pakët përveç Ilir Metës me 16% që ka pothuajse të njëjtin mbulim sa edhe partia e tij politike.

Total time

Context




SHQIPTARE



Politician soundbite

Politician context



SHQIPTARE

